



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:133111

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06362364

C.nr.3663/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.S nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.H, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilani, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit, vlera e kontestit 1,711.73 euro, jashtë seancës, me datë 17.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht bazuar kërkesëpadia e paditëses E.S nga Gjilani nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilani, që në emër të kualifikimit master për periudhën kohore, Shtator 2021–Janar 2023, për 17 muaj, duke llogaritur nga 100.69 euro për muajt Shtator 2021–Dhjetor 2021, si dhe duke llogaritur nga 94.86 euro për muajt Janar 2022–Janar 2023, t'ia paguaj paditëses shumë prej 1,635.94 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 10.05.2024 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumë prej 75.79 euro.

III. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 10.05.2024, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 1,711.73 euro.

Në padi të dt. 10.05.2024, ka theksuar se e njëjta është e punësuar në Shkollën Fillore të Mesme e Ulët (në vijim: SHFMU) “Esat Berisha” nëfshatin Llashticë Komuna e Gjilanit, në cilësinë e mësimdhënëses me kualifikim Mastert. Përkundër kualifikimit të saj master, asnjëherë nuk është kompensuar për atë që e përcakton baza ligjore për kualifikim nga e paditura si punëdhënëse, edhe pse ky ka qenë detyrim i së njëjtës. Për periudhën kohore Shtator 2021 – Shkurt 2023, e njëjti është kompensuar vetëm në shumën prej 46.66 euro për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhet në shumën prej 147.35 euro (sipas 35 % të pagës bazë), me ç’rast e paditura i ka mbetur borxh në shumën prej 100.69 euro në muaj. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej 1,711.73 euro, në emër të kualifikimit me master për periudhën Shtator 2021 – Janari 2023, për 17 muaj nga 100.69 euro në muaj. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 31.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditëja është në marrëdhënie punë tek e paditura (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar së paditëses me të paditurën, nr.prot.240 e dt.01.09.2022, si dhe vërtetimi me nr.prot.01-49/24 i dt.30.04.2024, lëshuar nga SHFMU “Esat Berisha” Llashticë).

Nuk është kontestuese se e njëjta ka diplomë të nivelit master nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.965 e dt.21.09.2021), dhe se pagën

bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 46.66 euro, në vitin 2021 kurse, në vitin 2022 në shumë prej 52.49 euro, (fakt i vërtetuar edhe nga lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK, për muajin dhjetor 2021 dhe për muajin tetor 2022).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditëses, pasi ka gjetur se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me master, meqë është paguar në shumën prej 46.66 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), për periudhen nga muaji Shtator 2021–Dhjetor 2021, kurse për periudhen nga Janar 2022–Janar 2023, është paguar në shumën prej 52.49 euro, ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, ndërsa është dashur të paguhet në shumën prej 147.35 euro (sipas 35 % të pagës bazë), me ç'rast e paditura i ka mbetur borxh në shumën prej 100.69 euro, për çdo muaj, për periudhen nga muajt Shtator 2021–Dhjetor 2021, kurse për periudhen nga muaji Janar 2022 - Janar 2023, i ka mbetur borxhë në shumë prej 94.86 euro në muaj, ndërsa periudha e aprovuar për këtë kompensim përfshin kohën sa ka qenë në fuqi Vendimi i Qeverisë dhe nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 10.05.2024, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga Shtatori 2021.

Gjykata vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi kërkesen për kompensimin e kualifikimit paditëja e ka kërkuar që të kompensohet me nga 100.69 euro, për për 17 muaj, kurse gjykata në bazë të listave të pages vërtetoi se e paditurat për periudhen nga

muaji Shtator 2021–Dhjetor 2021, ka kompensuar paditëse në shumë prej 46.66 euro për çdo muaj, e që i ka mbetur borxh në shumëm prej 100.69 euro, kurse për periudhen nga Janar 2021–Janar 2023, është paguar në shumen prej 52.49 euro, e që i ka mbetur borxh në shumë prej 94.86 euro.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil  
C.nr.3663/24, më datë 17.10.2024

Gjyqtarja,  
Edona Zuzaki

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj gjykate.